



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.233/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kujtim Pasuli kryesues, Hajriz Hoti dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.01.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.233/2025 e datës 28.01.2025.
- II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 5,000 (pesëmijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datë 28.01.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën pretendon se më datë 27.01.2025, në Skenderaj, mbështetësit e subjektit politik LVV, në një video të publikuar në mediat elektronike ndigjohen duke përdorur gjuhë të urrejtjes dhe fyese ndaj subjekteve politike kundërshtar ku thojnë “Me i ardhë Radojciqi e pranojnë me zemër. Kta nuk shkojnë me shkije, por shqiptarëve ia bajnë, shpiuna... Shpiunat e Serbisë, Idiota. Radojcin e kishin pritë me Lula. Ngo, ngo çka bajnë këtë gjest. Turp i madh. Tani thojnë PDK-ja jena njerëz. Kanë me hup shumë. Kështu e ka Drenica”. Parashtruesi ankesës thekson se kjo është gjuhë e cila përmban nxitje, urrejtje, ofendim, denigrim dhe njëherë shprehë ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese për partitë kundërshtarë, anëtarët mbështetësit dhe kandidatet e tyre. Më tutje në ankesë pretendohet se përdorimi i gjuhës së tillë nga mbështetësit e LVV, ka shkakuar indinjim dhe nxitje për dhunë tek grupet e izoluara të pranishme që kanë shprehur pakënaqësi ndaj Kryeministrit z.Albin Kurti dhe qeveris së tij, për gjuhën të cilën tashmë e kanë ndjellë në tubimet e mbajtura pothuajse në tërë territorin e Republikës së Kosovës, ku si pasoj e përdorimit të kësaj gjuhe ne shenjë revolte

janë shkaktuar edhe incidente te ndryshme, nga ky grup i izoluar për të cilat ka qenë i pashmangshëm edhe intervenimi nga ana e organeve të rendit dhe drejtësisë për stabilizim të situatës.

Me këtë sipas parashtruesit të ankesës është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 i cili shprehimisht thotë: *“përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.”* Sipas parashtruesit të ankesës,

Si provë që dëshmon shkeljen e pretenduar ka Cd me përmbajtje të videoincizimit të publikuar në mediat elektronike.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik LVV thekson se sjellja i përket fushatës zgjedhore edhe nëse kanë ndodhur këto shprehje nga aktivistet apo mbështetësit e Lëvizjes VETVENDOSJE! edhe nëse kemi të bëjmë me ofendime nuk janë të drejtuara për asnjë subjekt politik, por ndaj një grupi qytetarësh të cilët kanë qenë të revoltuar nga prezenca e subjektit politik në Skenderaj, të cilët ende janë të pa identifikuar. Me tutje në përgjigje në ankesë pretendojnë se ankesa vetëm tekstualisht mbështete në fakte, dhe se nga provat materiale evidentojmë vetëm njoftimin e bashkangjitur për tubimin e mbajtur, andaj gjuha e përdorur, ku lëshohet në përfundime të gabuara dhe paragjykuese subjekti politik PDK, të cilët mundohen të hedhin topin në subjektin LVV, ku nga videot shihet qartë disproporcioni për incidentin e ndodhura mes atyre që gjuanin, hedhnin dhe shkaktonin kaos në njërin ane dhe aktivistëve të LVV që u mohojnë Liria e Tubimit e cila është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Te njëjtit në përgjigjen në ankese theksojnë se postimi në fjale nuk është më aktiv dhe nuk krijon efekte negative e as pozitive dhe kërkojnë nga PZAP-i që ta refuzon ankesën.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, nga e cila rrjedh se mbështetësit e subjektit politik LVV, në një video të publikuar në mediat elektronike ndigjohen duke përdorur gjuhë të urrejtjes dhe fyese ndaj subjektit politik PDK, ku thuhet: *“Me i ardhë Radojciqi e pranojnë me zemër. Kta nuk shkojnë me shkije, por shqiptarëve ia bajnë, shpiuna... Shpiunat e Serbisë, Idiota. Radojcin e kishin pritë me Lula. Ngo, ngo çka bajnë këtë gjest. Turp i madh. Tani thojnë PDK-ja jena njerëz”*. Paneli vlerëson se kjo është gjuhë që është në kundërshtim me nenit 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërs si në vijim: ... 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit, gjuha e përdorur nga mbështetësit e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në tubimin zgjedhor konsiderohet si gjuhë nxitëse dhe urrejtëse kundrejt një subjekti politik në kuadër të fushatës zgjedhore dhe se kjo konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore, ngase ka për qëllim të krijojë atmosferë tensioni ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe të përçarjes ndaj të tjerëve. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike dhe në përgjithësi atmosfere destabiliteti. Përdorimi i gjuhës së tillë mund

të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë. Madje konsiderohet se Subjekti politik LVV nuk i është përmbajtura obligimit ligjor nga neni 35, par.2 të LZP, ku është përcaktuar se: *“Asnjë subjekt politik ose kandidatët nuk inkurajojnë, mbështesin ose miratojnë dhunën, kërcënimet me dhunë ose kanosje, gjatë procesit zgjedhor. Secili subjekt politik i informon anëtarët dhe mbështetësit e tij për nevojën për të shmangur një sjellje të tillë”*

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë ka bërë shkelje të natyrës së njëjtë e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), neni 118 paragraf 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr. 233/2025 më datë 30.01.2025



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së.